

REGJISTRI KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE - JANAR 2024

NR. RENDOR	DATA E KËRKESËS	OBJEKTI I KËRKESËS	DATA E PËRGJIGJES	PËRGJIGJE	MËNYRA E PËRFUNDIMIT TË KËRKESËS	TARIFA
1	17.01.2024	Ankesë për moszbatim të ligjit për marrje banese nga programi I rindërtimit	23.01.2024	Dërgim shkresë për kompetencë Bashkisë Tiranë	E plotë	Nuk ka
2	17.01.2024	Kërkesë për miratim ndryshimi të lejes	24.01.2024	Në përgjigje të shkresës suaj, me anë të cilës parashtroni pretendimet tuaja lidhur me ndryshimin e lejes së ndërtimit ju bëjmë me dije se: Rregullat dhe procedurat ligjore, që duhet të zbatohen nga autoritetet publike , në vijim të konfiskimit për interes publik të objekteve të ndërtuara pa leje apo në tejkalimin e lejes së ndërtimit, janë përcaktuar në ligjin 66/2023	E plotë	Nuk ka
3	18.01.2024	Kërkesë ankimore	31.01.2024	Në përgjigje të shkresës suaj, ju sqarojmë si më poshtë vijon: Pas verifikimit të kryer, që nga shtatori i vitit 2015 KKT nuk ka miratuar asnjë leje zhvillimi/ndërtimi në favor të shoqërisë...	E plotë	Nuk ka

4	22.01.2024	Informacion në lidhje me lejen e miratuar nga kryetari I Bashkisë	26.01.2024	Në përgjigje të shkresës suaj, ku kërkoni të informoheni mbi projektin e një objekti ndërtimor, leja e të cilit është miratuar nga Kryetari I Bashkisë, ju bëjmë me dije se: Referuar nenit 27 "Autoritetet Përgjegjëse", të ligjit 107/2014, Autoritetet përgjegjëse për zhvillimin e Territorit janë : Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Kryetari i Bashkisë... Për sa më sipër shkresën duhet t'ia drejtoni Bashkisë...	E plotë	Nuk ka
5	23.01.2024	Kërkesë për informacion	24.01.2024	Në përgjigje të kërkesës Suaj, Ju bëjmë me dije si vijon: Agjencia e Zhvillimit të Territorit, në bazë të Ligjit Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar është autoritet përgjegjës për zhvillimin e territorit si dhe kryen funksionet e sekretariatit teknik të Këshilli Kombëtar të Territorit. Për sa më sipër, si dhe referuar kërkesës Suaj, Ju konfirmojmë se nga verifikimi i kryer, nga shtatori i vitit 2015 (periudhë në të cilën AZHT ka filluar të ushtrojë funksionet e saj), e deri në momentin e lëshimit të kësaj shkrese, nuk është paraqitur asnjë aplikim për miratim leje ndërtimi nga KKT-ja, brenda sipërfaqes që keni evidentuar në kërkesën Tuaj	E plotë	Nuk ka
6	26.01.2024	Kërkesë	05.02.2024	Dërgim shkrese për kompetencë	E plotë	Nuk ka